



HAL
open science

Aspekte të ekonomisë antike ilire dhe epirote

Saimir Shpuza

► **To cite this version:**

Saimir Shpuza. *Aspekte të ekonomisë antike ilire dhe epirote*. Iliria, 2011, 2009-2010 (XXXIV), pp.91-110. <hal-04989670>

HAL Id: hal-04989670

<https://hal.science/hal-04989670v1>

Submitted on 16 May 2025

HAL is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.



HAL Authorization

ILIRIA



XXXIV

2009-2010

**QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I ARKEOLOGJISË
TIRANË**

ILIRIA
REVISTË ARKEOLOGJIKE

Nr. XXXIV

2009-2010

TIRANË 2011

Redaksia
Shpresa GJONGECAJ (Kryeredaktore)
Gëzim HOXHA (Sekretar i redaksisë)
Faik DRINI
Luan PËRZHITA
Elio HOBDARI

Redaktimi: Faik DRINI
Përgatitja grafike: Elio HOBDARI

ILIRIA
REVISTË ARKEOLOGJIKE

Në kopertinë: Mburojë nga nekropoli i Apolonisë. Shek. IV p. Kr.
Photo de couverture: Bouclier de la nécropole d'Apollonia, IV^e siècle av. J.-Ch.

PASQYRA E LËNDËS
TABLE DES MATIÈRES

NERITAN CEKA

Atintanët: një rivështrim mbi territorin dhe historinë e tyre 5
Les Atintanes, un nouvel aperçu de leur territoire et de leur histoire20

PIERRE CABANES

Un nouvel architecte à Lissos.....25
Një arkitekt i panjohur në Lissos.....27

SHPRESA GJONGECAJ

Të dhënat numizmatike nga Iliria e Jugut dhe Epiri i Veriut në shekujt V-I p.e.s. ...29
*Données numismatiques de l'Illyrie du Sud et d' Epire du Nord
aux Ve-Ier siècles av. J.-C.*58

BELISA MUKA

Lokalizimi i punishteve të prodhimeve qeramike në zonën gjeografike të
Ilirisë së Jugut dhe Epirit në antikitet dhe tipologjia e tyre61
*La localisation et la typologie des ateliers de production céramique en
Illyrie méridionale et en Epire dans l'Antiquité*75

PATRICIA KÖGLER

Abseits der Zentren – zwischen den Zentren: Die importierte und nicht
importierte Feinkeramik aus Lissos - Eine Studie zu den ökonomischen
und kulturellen Beziehungen der Stadt im späten Hellenismus77
*Larg qendrave-ndërmjet qendrave: Qeramika fine e importuar dhe
vendase nga Lissos -Një sprovë mbi marrëdhëniet ekonomike
dhe kulturore të qytetit gjatë periudhës helenistike të vonë*85

SAIMIR SHPUZA

Aspekte të ekonomisë antike ilire dhe epirote91
Aspects of ancient illyrian and epirotic economy107

NERITAN CEKA - SKËNDER MUÇAJ

Mbishkrime antike të pabotuara nga Bylisi, Elbasani, Tirana, Tetova dhe Gostivari111
Inscriptions antiques inédites de Byllis, Elbasan, Tetovo et Gostivar128

GËZIM HOXHA

- Commendatio animae - Lutje paradigme dhe skena biblike
në ritin mortor paleokristian nga provinca Praevalis131
*Commendatio animae – Paradigm prayer and biblical scenes
of the early Christian funerary ritual in the Praevalis province*148

FRANÇOIS BARATTE – LUAN PËRZHITA

- Llamba e Pecës153
La lampe de Pecë176

ELVANA METALLA

- Enë tryeze “Measles Ware” të zbuluara në qytetet Durrës dhe Vlorë187
*La céramique « Measles Ware » découvert dans les villes de Durrës
et de Vlora*194

ILIR GJIPALI

- Vendbanime të reja në Pellgun e Delvinës dhe në Bregdetin Jon201
New sites in southwest Albania211

ZHANETA ANDREA

- Tuma I e Shuecit (Rrethi i Korçës). Rezultatet e fushatës së parë të gërmimeve223

BURHAN DAUTAJ

- Qeramika e pikturuar helenistike e Dimalit281

VANGJEL DIMO

- Varri i një luftëtari. Varri nr. 56 i tumës 6 të nekropolit të Apolonisë323

ELIO HOBDARI

- Skulptura dhe instalimet liturgjike në kishën e Shën Mërisë
në Peshkëpi të Sipërme (Gjirokastër)331
*La sculpture et les installations liturgiques de l'église Sainte-Marie
à Peshkëpi e Sipërme (Gjirokastër)*350

ROBERTO PERNA – DHIMITËR ÇONDI

- Indagini archeologiche ad Hadrianopolis (Sofratikë) e nel territorio
della valle del Drino (campagne 2008-2010)365
*Kërkime arkeologjike në Hadrianopolis (Sofratikë) dhe në territorin
e Luginës së Drinosit (fushatat 2008-2010)*383

- Kronikë e gërmimeve 2009-2010387

- Botime të reja të viteve 2009-2010411

Saimir SHPUZA

ASPEKTE TË EKONOMISË ANTIKE ILIRE DHE EPIROTE

Autorët antikë¹ dhe gërmimet arkeologjike japin disa të dhëna të rëndësishme për ekonominë antike. Burimet natyrore dhe ekonomike luajtën rolin kryesor në shpërndarjen gjeografike të shumë siteve, qofshin këto urbane apo rurale. Në fakt, vëzhgimet sipërfaqësore të territorit kanë vënë në dukje një prani të madhe sitesh në zona gjeografikisht të izoluar dhe pa praninë e qyteteve apo qendrave të rëndësishme në rajon. Kjo na sugjeron se ishin pikërisht burimet natyrore ekonomike që bënë mundur ekzistencën e këtyre siteve dhe si rrjedhojë edhe mënyrën e organizimit të territorit.

Synimi i këtij artikulli nuk është thjesht shkrimi i një historie të ekonomisë antike, por edhe një provë për të analizuar tematikisht strukturat e kësaj ekonomie. Në kontekstin kur të dhënat që disponojmë janë të pakta, artikulli do të jetë më tepër përshkrues.

Në plan të parë termi ekonomi lidhet direkt me nocionet e punës, prodhimit, kapitalit, investimit, të të ardhurave, qarkullimit, sipërmarrjes, kërkesë-ofertës etj. Por në këtë punim do të fokusohemi vetëm në disa aspekte të ekonomisë antike ilire dhe epirote, si bujqësia, blegtoria dhe minierat. Gjithashtu edhe artizanati, element kyç i ekonomisë së qyteteve antike, nuk do të trajtohet në këtë punim. Kjo gjë na imponohet nga fakti se, megjithëse qytetet ishin qendrat prodhuese më të rëndësishme të artizanatit, qoftë ky qeramik, i përpunimit të metalit, lëkurës, tekstitit si dhe për industrinë e luksit si parfumet etj, në asnjë rast nuk janë gjetur atelie të tilla. Ndërkohë, shembujt material të këtyre prodhimeve janë të shumtë, por kërkojnë një analizë më të hollësishme. Për rrjedhojë do të fokusohemi më shumë në studimin e ekonomisë bujqësore, blegtorale dhe minerare; kjo e fundit shumë pak e studiuar në territorin e Shqipërisë.

Bujqësia dhe vilat

Bujqësia ishte degë kryesore e ekonomisë në antikitet me të cilën ishte e angazhuar

¹ Për autorët antikë do t'i referohemi vëllimit *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë. Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. I*, Tiranë, 1965, përgatitur nga F. Prendi, H. Ceka, S. Islami, S. Anamali. Në tekst do të paraqesim emrin e autorit dhe të veprës në variantin origjinal.

pjesa më e madhe e njerëzve². Për pjellorinë e territorit të Ilirëve na flasin edhe burimet historike. Për shembull, Herodoti më 478 p.e.s. tregon se rrotull Apollonisë kishte toka shumë pjellore që zotëroheshin nga aristokracia vendëse³. Ndërkohë që Skymni tregon për tokat pjellore të Ilirisë⁴, ndërsa Straboni shkruan për ullishtat dhe vreshtat e këtij vendi⁵.

Zhvillimi i bujqësisë në periudhën helenistike duket të ketë qenë i rëndësishëm. Kjo shihet te shfaqja e fermave bujqësore në territoret përreth qyteteve dhe nga zbulimi i veglave bujqësore nga gërmimet arkeologjike, si për shembull në Melgushë⁶, Antigone, Irmaj e Dimal⁷. Ky zhvillim i bujqësisë gjatë shekujve III-II p.e.s. pati si rrjedhojë rritjen e prodhimit, madje edhe në nivele eksporti, po të kemi parasysh faktin se tregtarët italikë shkonin në Epir jo vetëm për të eksportuar prodhimet e tyre, kryesisht verë e vaj⁸, por ndoshta edhe për t'u furnizuar me grurë⁹.

Për një ekonomi bujqësore të zhvilluar na informojnë indirekt edhe të dhënat historike mbi grabitjen e grurit të parthinëve dhe epirotëve nga romakët¹⁰. Ndërkohë që në zonën e Korçës, zbulimi i shumë pitosave na bën të mendojmë për praninë e shumë ndërtimeve me karakter bujqësor, ku depozitohej prodhimi¹¹. Fatkeqësisht nuk i njohim me saktësi ndërtimet të cilave u përkisnin këto pitosa, por kjo krahinë njihet për fushat e saj shumë pjellore. Edhe në antikitet, siç na informojnë autorët e asaj kohe, Dasaretia e kishte këtë karakteristikë. Gjatë luftës së dytë të Maqedonisë, në vitin 199 p.e.s., konsulli romak *Sulpicius* kaloi nëpër Dasareti dhe e furnizoi ushtrinë e tij me prodhimet që i ofronte krahina, për më tepër që banorët nuk kishin bërë asnjë lloj rezistence¹².

Edhe hambarët e mëdhenj të zbuluar në Qesarat na ofrojnë një shembull të jashtëzakonshëm të sasisë së prodhimit bujqësor, si dhe të mënyrës së ruajtjes së tij¹³.

² M. I. FINLEY, *L'économie antique* (përkthyer nga anglishtja nga P. Higgs), Paris, 1975, f. 128.

³ HERODOTI, *Historiae*, IX, 94.

⁴ SCYMNI CHII, *Orbis Descriptio*, 375.

⁵ STRABONIS, *Geographica*, VII, 317.

⁶ M. DIBRA, *Një depo me vegla bujqësore ilire nga fshati Melgushë, Iliria*, 1981, 1, f. 235-237.

⁷ F. PRENDI, Dh. BUDINA, *Kalaja e Irmajt, Gërmime të vitit 1960, Iliria* 1972, II, Tab. XV ; Dh. BUDINA, *Antigonea, Iliria* 1972, II, fig. 35, 36, 37, 38, 39.

⁸ Shih S. SHPUZA, *Importimi dhe prodhimi i verës dhe vajit në Ilirinë e jugut (shekujt III-I p.e.s.)*, *Iliria*, 2005-2006, XXXIII, f. 219-233.

⁹ POLYBI, *Historiae*, II, 8.

¹⁰ CAESARIS, *Belli Civilis*, XLII, 3.

¹¹ P. LERA, *Pitose antikë me vula nga Korça, Iliria*, 1983, 2, f. 211.

¹² LIVIUS, *Ab Urbe Condita*, XXXI. 33, 4: "Konsulli (*Sulpicius*) nuk e përgatiste, por e bënte luftën. Ai u nis me ushtrinë e tij për në krahinën e dasaretëve dhe gjithë drithin që mori me vete nga kampi i tij i dimrit, nuk e harxhoi, meqenëse tokat (e dasaretëve) kishin mjaft bereqet për ushtarët. Qytetet dhe fshatrat iu dorëzuan disa me dëshirë, disa prej frikës; disa i pushtoi me forcë, të tjerat i gjeti të braktisura meqenëse barbarët ishin larguar nga malet e afërta. Lëmin e vendosi në Lynk, pranë lumit Bevo; prej këndej dërgonte për të marrë drithë në hambarët e dasaretëve."

¹³ K. ZHEKU, *Hambarë të nëndheshëm në Qesarat, Iliria*, 1983, 2, f. 224.

K. Zheku, autori i gërmimit, e lidh praninë e këtyre hambarëve me luftërat civile, të cilat patën si teatër kryesor luftimesh territorin ilir. Megjithatë duhet të theksojmë se nuk ekziston asnjë e dhënë arkeologjike që t'i datojë këto hambarë në këtë datë!

Furnizimi i ushtrisë me ushqime ishte ndër problemet kryesore të luftës. Siç tregon dhe vetë Çezari, qëllimi i tij kryesor ishte që të marshonte sa më shumë dhe të furnizohej sa më lehtësisht. Kur tentoi të rrethonte Pompeun në Dyrrah, pati synim që ta izolonte këtë të fundit nga kontinenti. Megjithatë, Pompeu i kishte marrë masat dhe furnizohej me ushqime nga deti. Ndërsa Çezari, nga ana e tij, ishte i detyruar të furnizohej nga krahinat përreth¹⁴.

Siç kuptohet indirekt nga këto burime të autorëve antikë, luftërat kanë shkaktuar dëme të mëdha, përse i takon prodhimit bujqësor, por nga ana tjetër tregojnë edhe se prodhimet bujqësore të Ilirëve ishin vërtet të një sasive të konsiderueshme, sa mund të mbanin me furnizime dhe ushtri të mëdha romake¹⁵.

Në rast se në periudhën helenistike burimet antike dhe të dhënat arkeologjike dokumentojnë një prodhim të madh bujqësor, në periudhën romake kemi shfaqjen e një strukture të re që lidhet me ekonominë dhe prodhimin. Kjo strukturë përfaqësohet nga vilat që përbëjnë dhe ndërtimet më të rëndësishme në territorin rural të periudhës romake. Përveç kësaj, ato përbëjnë në vetvete një institucion ekonomik që organizon punën dhe prodhimin bujqësor në fshat¹⁶. Vilat në territorin e Shqipërisë së sotme njihen më shumë në zonën e Epirit sesa në atë të Ilirisë së Jugut (fig. 1). Vëzhgimet e pakta të realizuara e bëjnë të vështirë krijimin e një kuadri të qartë të shpërndarjes së tyre dhe si rrjedhojë edhe të organizimit të bujqësisë në fshatin ilir. Megjithatë, ky territor që po marrim në konsideratë, paraqet disa veçori përse i takon evoluimit të këtyre monumenteve.

Diaporiti është një nga vilat më mirë të gërmuara vitet e fundit. Ndërtimi i këtij monumenti ka njohur disa faza. Fillimet i takojnë periudhës helenistike dhe republikane, ndërsa faza e dytë periudhës perandorake. Është pikërisht kjo fazë e dytë ndërtimi që i jep monumentit formën e një vile të vërtetë. Vila më pas braktiset në shekullin III e.s., por aktivitete të tjera duket se zhvillohen në të, siç është për shembull ndërtimi i furrave të qeramikës dhe i një bazilike paleokristiane¹⁷.

¹⁴ CAESARIS, *Belli Civilis*, XLII.

¹⁵ Rritja e rolit të ekonomisë bujqësore në shoqërinë ilire dhe epirote në shekujt III-II p.e.s. duket edhe në shfaqjen e perëndive rustike të lidhura me aktivitetin bujqësor, si për shembull rasti i Panit në Butrint. Një element tjetër me rëndësi që ilustron rëndësinë e prodhimit bujqësor është edhe shfaqja e parmendës dhe kallinjve të grurit në monedhat e Apollonisë dhe prerjeve të mbretit *Ballaios*.

¹⁶ P. GROS, *L'architecture romaine du début du IIIe siècle av. J.-C. à la fin du Haut-Empire*, II. Paris, 2001, f. 276. Sipas këtij autori, vila konsiderohet si një faktor i zhvillimit ekonomik, por që nga ana tjetër tregon dhe kontrollin që kishin elitat qytetare mbi fshatin.

¹⁷ R. HODGES, W. BOWDEN, *Butrinto nell'età tardo antica*, G. P. BROGIOLO, P. DELOGU (éd.), *L'Adriatico dalla tarda Antichità all'età carolingia*, Firenze, 2005, f. 7-47. Shih W. BOWDEN, L. PËRZHITA, Excavations at the Roman villa and Early Christian complex at Diaporit, *Candavia* 3, 2011, f. 5-27.



Fig. 1. Shpërndarja e vilave romake në Ilirinë e Jugut dhe Epir.

Ndërkohë Dobra¹⁸, Çuka¹⁹, Metoqi dhe Malathrea²⁰ përbëjnë shembullin më tipik të vilave epirote (fig. 2). Në të vërtetë, këto monumente janë ferma të vogla dhe të fortifikuara helenistike, të cilat në periudhën romake transformohen në vila. Fakti që këto monumente zmadhohen në periudhën romake, tregon se kemi një rritje të rëndësishme të prodhimit bujqësor. Në këtë aspekt me siguri ka ndikuar direkt edhe futja e teknikave të reja të punimit të tokës si dhe të mjeteve të reja të punës, të cilat deri në periudhën pararomake kishin njohur një përmirësim të paktë²¹. Në asnjërën prej tyre nuk kemi gjetur mozaikë apo skulptura, çka tregon se nuk kemi të bëjmë me vila luksi, të cilat përveç rolit prodhues luajnë edhe rol rezidencial. Plani i këtyre monumenteve është shumë kompakt, ku të gjitha ambientet që përdoren për depozitimin e prodhimit bujqësor, organizohen rrotull një oborri qendror, i ngjashëm me atë të një peristili. Ekzistojnë shumë teori në lidhje me rolin e fortifikimit të këtyre fermave, por më të pranueshmet janë ato që i lidhin këto fortifikime me ruajtjen e

¹⁸ Dh. ÇONDI, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1984-Dobër (Sarandë), Iliria*, 1984, 2, f. 266-267; *id. Gërmimet arkeologjike të vitit 1986 - Dobër (Sarandë), Iliria*, 1986, 2, f. 262-263.

¹⁹ E. GIORGI, *Ricerche e ricognizioni nel territorio*, në S. De Maria, Sh. Gjongecaj (ed.) *Phoinike I*, Firenze, 2002, f. 123.

²⁰ Dh. ÇONDI, *Fortesa-vilë e Malathresë, Iliria*, 1984, 2, f. 131-152.

²¹ A. BRESSON, *L'économie de la Grèce des cités. I. Les structures et la production*, Paris, 2007, f. 77.




Fig. 2. Planimetritë e vilave romake njohura në Epir. (Diaporit (sipas R. Hodges, W. Bowden, *Butrinto nell'età tardo antica*, në G. P. Brogiolo, P. Delogu (éd.), *L'Adriatico dalla tarda antichità all'età carolingia*, Firenze, 2005, fig. 16), Malathre (sipas Dh. Çondi, *Fortresa-vilë e Malathresë...* 1984, fig. 2), Çuka (sipas E. Giorgi, *Ricerche e ricognizioni nel territorio*, në S. De Maria, Sh. Gjonecaj (éd.), *Phoinike I*, Firenze, 2002, fig. 23), Çumpora (sipas Dh. Budina, *Harta arkeologjike...* 1971, fig. 17) dhe Metoqi (sipas Dh. Budina, *Harta arkeologjike...* 1971, fig. 9).

prodhimit²². Ndoshta kemi të bëjmë me të njëjtat kulla që përmend Çezari, me anë të të cilave furnizonte me ushqime ushtrinë e tij²³. Gjatë periudhës romake kullat mbrojtëse të këtyre monumenteve dalin jashtë funksionit, ndërkohë që shtohen ambientet e depozitimit të prodhimit bujqësor. Transformimi i kryer nga romakët ndoshta lidhet me praninë e sipërmarrësve italikë, prania e të cilëve ndikoi në mënyrat dhe teknikat e prodhimit, çka rriti edhe sasinë e tij.

Nuk duhet lënë jashtë vëmendjes fakti se përveç rimarrjes dhe riorganizimit nga romakët të monumenteve helenistike, disa prej tyre e vazhdojnë jetën edhe në antikitetin e vonë. Për këtë mund të përmendim rastin e Dobrës, Metoqit dhe Diaporitit, ku shikojmë ndërtimin e kishave. Me siguri fertiliteti i tokave përreth vendndodhjes së këtyre monumenteve bëri që jeta të vazhdonte në këto site.

Përsa i takon pranisë së vilave në Ilirinë e jugut, ato i gjejmë kryesisht rrotull territoreve të kolonive romake, pasi në këto qytete jetonte një elitë, e cila zotëronte toka të shumta. Për shembull, në zonën e Shkodrës janë të identifikuar dy vila, njëra që mendohet e shekullit II e.s., e gjetur në qytet²⁴, dhe një tjetër në fshatin Melgushë. Ndërsa rrotull kolonisë së Dyrrahut shohim praninë e vilave romake në Luz të vogël, Kryemëdhënj dhe Bashtovë²⁵. Një ndërtim i tillë duket se është identifikuar edhe në Darzezë²⁶. Megjithëse të pagërmuara, prania e tyre është shenjë e përhapjes së vilës në Iliri, jo thjesht si mënyrë jetese romake, por edhe si institucion që organizon jetën ekonomike në fshat. Këto vila ishin të ndërtuara në tokat më të mira bujqësore dhe pranë qyteteve e rrugëve kryesore të komunikimit, pasi prodhimet e tyre ishin të destinuara kryesisht për tregun e qytetit.

Megjithëse shembujt e vilave në territorin ilir dhe epirot sa vijnë e shtohen, ato nuk janë e vetmja formë e organizimit të prodhimit bujqësor. Në shumicën e territorit vërejmë një prani të madhe sitesh rurale, çka na vë në dukje një territor mjaft të fragmentuar dhe ku, me sa duket, mungojnë zotërimet e mëdha. Idenë tonë mbi fragmentimin e territorit na e përforcon edhe më tepër fakti se nekroplet rurale të periudhës romake përbëhen nga shumë pak varre²⁷. Në këtë kontekst, mendojmë se në këto site rurale baza e

²² T. J. Smith, *Roman villas. A study in social structure*, London, 1997, f. 216. S. P. MORRIS, J. K. PAPADOPOULOS, *Greek towers and slaves : An archaeology of exploitation*, *American Journal of Archaeology*, 109, 2005, f. 155-225.

²³ CAESARIS, *Belli Civilis*, III, 46.

²⁴ Z. TAFILICA, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1990, Shkodër, Iliria*, 1990, 2, f. 263-264.

²⁵ H. MYRTO, *Hartë e monumenteve dhe gjurmëve antike e mesjetare të Durrësit, Monumentet*, 1982, 1, f. 25.

²⁶ Gj. KARAIKAI, *Vrojtime arkeologjike në rrethin e Gramshit, Monumentet*, 1972, 3. f. 199.

²⁷ S. SHPUZA, *L'espace rural illyro-épirote. Contribution à l'étude de l'occupation du territoire et de l'économie à l'époque romaine en Illyrie méridionale et en Chaonie*, në *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité V*, Actes du Ve colloque international de Grenoble (8-11 octobre 2008), Jean-Luc Lamboley, Maria Paola Castiglioni, Paris, 2010, p. 607-616.

Blegtoria

Rritja e kafshëve në Epir përbënte aspektin ekonomik më të zhvilluar dhe më të organizuar. Këtë fakt e konfirmojnë edhe autorët antikë, si për shembull Varroni që merr tek epirotët shembujt më të mirë të rritjes së kafshëve³⁸. Ndërsa Plini nga ana e tij përmend demat e Epirit si më të mirët dhe për këtë meritën kryesore ia atribuon Pirros, i cili kishte treguar një kujdes të madh për rritjen e tyre³⁹. Rritja e kafshëve nga epirotët përmendet edhe nga Çezari, i cili vë në pah cilësinë e mirë të dhenve që rriten në masë të konsiderueshme në këtë rajon⁴⁰.

Blegtoria epirote me siguri ka pasur si rrjedhojë edhe zhvillimin e disa produkteve të tjera, si për shembull prodhimin e qumështit, përpunimin e mishit dhe prodhimin e leshit. Sipas Varronit, që prodhimi i leshit të ishte i një cilësie të mirë, dhentë duhej të mbaheshin në ferma të mbuluara⁴¹. Ndërsa Plini na përmend si me nam leshin e Histrisë dhe Liburnisë që u përngjan fijeve të flokut⁴². Fatkeqësisht gërmimet arkeologjike nuk kanë identifikuar ende ndërtime të tilla të mbuluara me çati. Ne nuk njohim as punishtet ku bëhej ky përpunim i leshit, megjithëse kjo industri duhet të ketë qenë nga më kryesoret po të kemi parasysh sasinë e madhe të prodhimit dhe të fitimit. Në këtë kontekst, kur të dhënat arkeologjike për momentin mungojnë, mund të supozojmë se leshi i prodhuar në Epir eksportohej dhe përpunohej në Itali. Për më tepër, edhe rritja e kafshëve, që nga shekulli II p.e.s. ndodhej kryesisht në duart e sipërmarrësve italikë.

Përveç leshit dhe mishit, nga rritja e bagëtive në antikitet ishte mësuar të përftohej edhe djathi. Janë sërish autorët antikë që na informojnë se për këtë prodhim njihej shumë zona e Dardanisë, e cila prodhonte *caseus dardanicus* (djathë) që krahasohet më tej me *caseus vlahescus*⁴³.

Një kafshë tjetër e rritur nga epirotët është kali. Një tekst i *Gjeorgjikeve* të Virgjilit ku përmenden kuajt e Epirit, na bën të mendojmë se edhe ata eksportohejshin në Romë duke qenë se i vlerësonin për cilësitë e tyre⁴⁴. Ndoshta sipërmarrësit italikë e zhvilluan

dobishme që t'u jepen atyre me vehte gra, të cilat duke shkuar pas kopesë t'u bëjnë të hanë barinjve dhe t'i lidhin pas punës. Por duhet që këto gra të jenë të forta, të mos jenë të turpshme dhe që në punë të mos mbeten mbrapa nga burrat, siç ndodh në shumë vende. Në Iliri ka të tilla që ruajnë dhentë ose shkojnë për dru, ose gatuajnë, ose ruajnë kasollen."

³⁸ VARRONIS, *De Re Rustica* II, 2.

³⁹ ARISTOTELI, *De Animalium Historia*, VIII, 7,593b ; PLINI, *Naturalis Historiae*, VIII, 48, 7: "Në hemisferën tonë gjedhet epirote lavdohen së tepërmi. Kjo racë, sikurse thonë, i detyrohet kujdesit të Pirros; ai ia arriti kësaj duke mos lejuar ndërzimin e femrave para se të mbushnin katër vjeç. Kështu pra, ato u rritën shumë dhe nga kjo racë kanë mbetur edhe sot e kësaj dite."

⁴⁰ CAESARIS, *Belli Civilis*, III, 47.

⁴¹ VARRONIS, *De Re Rustica*, II .2.18-20.

⁴² PLINI, *Naturalis Historiae*, VIII, 48, 73.

⁴³ ANONYMI, *Descriptio totius mundi et gentium*, A 51, A 53.

⁴⁴ VERGILIUS, *Georgica*, I, 56: "A nuk e sheh se si Tmoli aromatin e safranit na dërgon, kurse India – fildishin dhe sabejt e butë – thimjanin, Halibët e zhveshur – hekurin, dhe Ponti

edhe më shumë traditën e rritjes së kuajve që ekzistonte para ardhjes së tyre⁴⁵.

Tradita e madhe blegtorale në Epir kishte nevojë edhe për terrene të mëdha jo të kultivueshme, që njihen gjatë periudhës romake me termin *ager compascuus*. Kjo përkon me një pronë të përbashkët të të gjithë komunitetit, të cilën askush nuk mund ta privatizonte⁴⁶. Në fakt prona kolektive në Epir njihej edhe para ardhjes së romakëve dhe ndoshta kjo situatë nuk ka ndryshuar pas ardhjes së tyre. Disa site paraqesin një karakter krejtësisht blegtoral, pasi në shumicën e rasteve bëhet fjalë për ndërtime pa cilësi dhe të përbëra kryesisht vetëm nga një portë. Brendësia e tyre nuk mbart asnjë gjurmë të organizimit të hapësirës dhe në shumicën e rasteve janë ndërtuar në terrene shkëmbore dhe me sipërfaqe modeste. Këto site mund të kenë qenë të përbashkëta për të gjithë komunitetin. Të tilla mund të kenë qenë Ripësi dhe Paleomanastri (fig. 3).

Varroni mbetet informacioni kryesor për ekonominë ilire dhe epirote, meqë i ka shëtitur vetë këto vende. Ai ka mbledhur informacione të sakta kur ishte pjesë e ushtrisë së Ilirikumit në vitet 78-77 p.e.s. dhe më pas shoqëronte Pompeun në luftën e tij kundër piratëve si dhe gjatë qëndrimit në Dyrrah përgjatë luftës civile. Megjithatë




Fig. 3. Planimetritë e Ripësit dhe Paleomanastrit. (Paleomanastri sipas Dh. Budina, *Harta arkeologjike...* 1971, fig. 27) dhe Ripës (sipas Dh. Budina, *Kalaja e Ripësit...* 1971, fig. 2).

lëngun me erë të fortë të Kastorit, kurse Epiri – kuajt e fitoreve elidike.”

⁴⁵ R. ÉTIENNE, *Hippotrophia - aspects sociaux de l'élevage des chevaux en Grèce*, A. Gardeisen (éd.) *Les équidés dans le monde Méditerranéen antique*, actes du colloque organisé par L'Ecole Française d'Athènes, le Centre Camille Jullian (Athènes, 26-28 Novembre 2003), Lattes, 2005, f. 247.

⁴⁶ FRONTINUS, *Strategematum*, 55.

shumica e informacioneve që na jep, janë të fragmentuara dhe prej tyre nuk mund të nxjerrim shumë konkluzione. Ndër të tjera, ky autor na informon për ekzistencën e buajve të egër në Dardani⁴⁷ si dhe për qentë molosë që ishin të mëdhenj e të zinj, të cilët përdroreshin shumë për ruajtjen e bagëtive⁴⁸. Një informacion tjetër me vlerë i Varronit për një artikull tjetër që eksportohej në Itali, është mbi kërmijtë e Ilirisë, shumë të njohur në Romë dhe nga më të mëdhenjtë në treg⁴⁹.

Element tjetër i rëndësishëm i ekonomisë ilire ishte dhe peshkimi. Me shumë mundësi ky aktivitet ishte i përqendruar në qytetet bregdetare të Ilirisë, por nuk duhet të harrojmë dhe pasurinë e lumenjve dhe liqeneve me peshq. Për shembull, Straboni përmend liqenin e Ohrit si një vend ideal për kripjen dhe tharjen e peshkut⁵⁰.

Minierat

Minierat janë aspekti i ekonomisë ilire më pak i njohur deri më sot. Në këtë kontekst, burimet e autorëve antikë përbëjnë pikënisjen e studimit të tyre. Studimi i minierave përmban shumë vështirësi që lidhen kryesisht me identifikimin e tyre. Sidomos këto vështirësi janë më të mëdha për periudhën pararomake, kur shfrytëzimi i minierave bëhej vetëm në sipërfaqe, pa hapje galerish. Në territorin e Shqipërisë njihen vetëm sporadikisht disa galeri minierash antike. Ugolini na sinjalizon se kishte parë gjurmë të nxjerrjes së minareleve pranë *Lissus*-it, pranë lumit Fand dhe Bulgjer, por i konsideron këto galeri si të periudhës mesjetare. Përsëri Ugolini na bën me dije se në Pukë një shoqëri italiane që kishte marrë me koncesion një minierë, kishte rënë në gjurmët e një galerie romake⁵¹. Një tjetër minierë antike është sinjalizuar në Gjegjan të Kukësit. Jo vetëm minierat, por edhe përpunimi i metalit njihej shumë mirë nga ilirët. Për këtë, përveç burimeve antike na vjen në ndihmë edhe ikonografia e monumenteve sepulkrale. Për shembull, nga Dasaretia, edhe kjo një zonë e pasur me minerale, na vjen një stelë e shekullit III e.s. ku paraqiten dy hekurpunues (fig. 4).

Ndërkohë që të dhënat arkeologjike mbi minierat antike në Shqipëri janë shumë të varfëra, e kundërta ndodh me burimet e autorëve antikë. Këto burime janë shumë të pasura dhe na japin informacion për një periudhë të gjatë kohore. Për shembull, Straboni na informon se Iliria, ashtu si dhe Mezia, ishte e njohur për minierat e hekurit⁵². Nga ana

⁴⁷ VARRONIS, *De Re Rustica*, II, 1, 4.

⁴⁸ VARRONIS, *De Re Rustica*, II, 9, 4.

⁴⁹ VARRONIS, *De Re Rustica*, III, 14.4.

⁵⁰ STRABONIS, *Geographica*, VII, 7, 8. Si tharja e peshkut ashtu dhe rritja e kafshëve në Epir kishin nevojë për sasi të konsiderueshme kripe. Për këtë shihni një libër botuar së fundmi nga C. Carusi, *Il sale nel mondo greco (VI a.C. – III d.C.). Luoghi di produzione, circolazione commerciale, regimi di sfruttamento nel contesto del Mediterraneo antico*, Bari 2008.

⁵¹ L.M. UGOLINI, *Albania Antica*, Roma, 1927 (*Shqipëria e lashtë*, Tiranë, 2009, përkthyer në shqip nga Qemal Veliu) f. 185.

⁵² STRABONIS, *Geographica*, V, 1.8.



Fig. 4. Stelë nga Dasaretia që prezanton dy hekurpunues. (sipas Albanien 1989, fig. 247).

tjetër, Tit-Livi, kur përshkruan riorganizimin që i bënë romakët territorit ilir pas luftës me Gentin, thotë se ata e ndaluan shfrytëzimin e minierave të argjendit dhe të arit nga ilirët, por i lejuan të vazhdonin shfrytëzimin e minierave të hekurit dhe bakrit⁵³. Teksti i Tit-Livit hedh dritë edhe mbi faktin se minierat ishin një burim i rëndësishëm ekonomik për romakët dhe se me pushtimin e Ilirisë këto miniera vihen nën kontrollin e tyre direkt. Ndërkohë kuptojmë se para ardhjes së romakëve, minierat ishin dhënë me koncesion dhe se sipërmarrësit i paguanin taksa mbretit Gent⁵⁴. Ky rast përbën të vetmin shembull, nëpërmjet të cilit kuptojmë se mbretërit ilirë aplikonin një politikë taksash. Kjo tregon se në njëfarë mënyre ekonomia antike ilire ka pasur një organizim shtetëror, gjë që vërtetohet edhe nga disa informacione që na vijnë nga autorët e asaj kohe⁵⁵. Në rastin e mbretit Gent, atij iu konfiskua nga romakët një pasuri shumë e madhe, e përbërë nga 27 ponde ari, 19 argjendi, 13 000 denarë dhe 120 000 monedha argjendi të Ilirisë⁵⁶. Ndoshta ky akumulim i madh pasurie mund të ishte pjesërisht rrjedhojë e kësaj politike taksash dhe pjesërisht rrjedhojë e aktivitetit pirat që kryenin ilirët.

⁵³ LIVIUS, *Ab Urbe Condita*, XLV, 29, 11.

⁵⁴ LIVIUS, *Ab Urbe Condita*, XLV, 29.11: “Shfrytëzimi i minierave të floririt dhe të argjendit u ndalua, kurse i atyre të hekurit dhe bakrit u lejua. Shfrytëzuesit e minierave ngarkoheshin me gjysmën e taksave, të cilat ia paguanin mbretit.”

⁵⁵ SHIH POLIBIUS, *Historiae*, XXIX 13, 2; XLIV 27, 11; LIVIUS, *Ab Urbe Condita*, XXV 26, 13-15; XXX 28, 1-2; XLIX 30, 4; XLV 26, 13-14; 27, 11.

⁵⁶ LIVIUS, *Ab Urbe Condita*, XLV 43, 4: “Në triumf kishte me vete shumë flamuj ushtarakë, plaçkë tjetër dhe orenditë e mbretit; solli njëzet e shtatë ponde ari, nëntëmbëdhjetë ponde argjendi, trembëdhjetë mijë denarë dhe njëqind e njëzetmijë copë monedha ilire prej argjendi.”

Dy autorë të tjerë na japin informacion të rëndësishëm për minierat e Ilirisë. Marciali nga ana e tij u njeh ilirëve një traditë të gjatë të përpunimit të metalit, që nga periudhat më të hershme⁵⁷, ndërsa Paulin Noliani përmend fisin e besëve që kishin monopolin e minierave⁵⁸.

Megjithëse autorët që flasin për minierat ilire janë romakë, ata indirekt informojnë se që para ardhjes së romakëve në Iliri kishim një aktivitet të rëndësishëm minerar. Këtë situatë e dëshmon dhe prerja e një sasive të konsiderueshme monedhash argjendi nga Damastioni. Një seri e këtyre monedhave paraqet edhe veglat e punës që përdorshin në miniera, si për shembull çekiçi apo lingotat⁵⁹. Këto prerje, që i takojnë shekullit IV p.e.s., tregojnë se kemi një shfrytëzim intensiv të minierave të argjendit që në fillim të periudhës helenistike. Përsa i takon vendndodhjes së Damastionit, sipas Strabonit, ndodhet mes Dyrrahut, Apollonisë dhe maleve Akrokeraune⁶⁰. Ky autor shton gjithashtu që qyteti ishte nën autoritetin e fisit të dyestëve dhe enkelejdëve, shtrirja e të cilëve arrinte deri pranë liqenit të Ohrit⁶¹.

Në periudhën romake, gjatë sundimit të Neronit, disa nga minierat në Iliri arrinin të prodhonin deri 50 livra ar në ditë⁶². Minierat e arit autorët antikë i vendosin kryesisht në Dalmaci, siç na informon dhe Staci⁶³. Në këtë provincë, nga mbishkrimet e zbuluara deri më sot, njohim edhe prokuratorët (*procuratores*) që dërgoheshin nga Roma për të ndjekur punimet në këto miniera⁶⁴. Ndërsa për periudhën e Trajanit mësojmë se fisi ilir i pirustëve u zhvendos në Transilvani nga ky perandor, pikërisht sepse konsideroheshin si minatorë me shumë eksperiencë. Emrat e kësaj popullsie ilire shfaqen më pas edhe në mbishkrimet e gjetura në Daki⁶⁵. Gjithashtu edhe Flori përmend se në kohën Augustit, ky i fundit i dha urdhër Viviut, mëkëmbësit të Dalmacisë, që të detyronte popullsinë vendase për të punuar në minierat e xeherorëve⁶⁶.

⁵⁷ MARTIAL, *Epigrammes*, X, 78.5.

⁵⁸ PAULIN NOLIAN, *Carmina*, XVII, 214.

⁵⁹ J.M.F. MAY, *The coinage of Damastion and the lesser coinages of the Illyro-Paeonian region*, London, 1939, Pl. XI, no 10-29; Pl. XII.

⁶⁰ STRABONIS, *Geographica*, VII, 7, 7.

⁶¹ Straboni është i vetmi autor që na informon për vendndodhjen e Damastionit. Nga ana tjetër përshkruan një zonë shumë të gjerë, çka ka sjellë dhe një sërë hipotezash lidhur me vendndodhjen e qytetit antik. Shumica e hipotezave e vendosin këtë qytet në Maqedoninë e sotme. Për shembull O. Davies, *Roman mines in Europe*, Oxford, 1935, f. 239, duke u mbështetur pikërisht te Straboni, mendon se Damastioni mund të ndodhet në zonën e Dibrës. Ne, duke u nisur nga fakti se shumica e monedhave të Damastionit janë gjetur në territorin e Kosovës dhe meqë atje kemi njohuri edhe për miniera argjendi, mendojmë se ky qytet duhet kërkuar në Kosovë. Megjithatë, debati mbetet i hapur derisa arkeologët të dëshmojnë vendndodhjen e tij.

⁶² PLINI, *Naturalis Historiae*, XXXIII, 67.

⁶³ STACI, *Silves*, IV, 7, 14-16; I, 2, 153; III, 3, 90.

⁶⁴ *CIL* III, 6575.

⁶⁵ R. CIOBANU, *Les Illyriens et la Dacie romaine*, P. Cabanes (éd.) *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité, Actes du IIIe colloque de Chantilly (16-19 octobre 1996)*, Paris, 1999, f. 313-324. Me shumë mundësi, këto zhvendosje popullsish në antikitet kryheshin me forcë, shih Flori II, XXV.

⁶⁶ FLORUS, *Epitomae*, I, III, 25

organizimit ekonomik ishin familjet e vogla që punonin një sipërfaqe të vogël toke, prodhimi i së cilës shkonte vetëm për përdorim vetjak. Kjo formë organizimi ekonomik ishte shumë e njohur në të gjitha territoret e Perandorisë Romake²⁸. Pra kemi të bëjmë me një shoqëri thellësisht agrare, për të cilën toka ishte pasuria kryesore. Kjo formë e organizimit ekonomik me shumë mundësi ka ruajtur dhe sistemet e vjetra të punës në bujqësi, sidomos në zonat e izoluara dhe larg akseve kryesore të komunikimit. Duke qenë se kemi të bëjmë kryesisht me një ekonomi të fragmentuar në disa familje që zotëronin nga një ngastër toke, rrjedhimisht edhe prodhimi që krijonin, ishte vetëm për përdorim familjar dhe jo për t'u shitur në treg²⁹. Për këtë arsye, mendojmë se ekonomia antike ilire ishte “primitive”, duke pasur parasysh se sasia e prodhimit në përgjithësi ishte e vogël, teknologjia prodhuese njohu zhvillime të pakta, si dhe bujqësia, që përbënte elementin kryesor të ekonomisë, binte shpesh pre e variacioneve të klimës, nga njëri vit në tjetrin.

Ekzistenca e ekonomisë familjare lidhet direkt edhe me problemin e monetarizimit të ekonomisë antike tek ilirët. Në këtë kuadër nuk është e rastit që gjetjet monetare në territorin rural janë shumë të pakta³⁰, çka tregon se nuk kemi të bëjmë me një ekonomi monetare, sepse mbiprodhimi ishte një fenomen i rrallë. Monedha, megjithëse pritej që në shekullin IV p.e.s. nga Apollonia e Dyrrahu dhe më pas në shekullin III kemi një shtim të konsiderueshëm të atelieve monetare, nuk arriti të luante një rol kryesor në shkëmbimet ekonomike. Në këtë kontekst, mendojmë se nuk kemi të bëjmë vërtet me një ekonomi monetare dhe se monedha ka luajtur një rol dytësor. Monetarizimi i ekonomisë lidhet direkt me mbiprodhimin dhe ishte pikërisht pjesa e mbiprodhuar që përjashtohet nga autokonsumimi dhe që mund të shitej kundrejt një vlere monetare.

Një tekst i Varronit hedh më tepër dritë mbi këtë formë organizimi ekonomik³¹. Duke qenë se bujqësia ishte dega më e përhapur e ekonomisë në antikitet, ajo kërkonte angazhimin e një numri të madh krahu pune. Ky krah pune përbëhej nga fshatarë të lidhur ngushtë me tokën, nga skllëverit, si dhe nga disa njerëz të lirë. Skllavëria ishte e

²⁸ P. GARNSEY, R. SALLER, *L'Empire Romain ; économie, société et culture* (përkthyer nga anglishtja nga F. Regnot), Paris, 2001, f. 82.

²⁹ Përsa u takon marrëdhëniet e fshatarëve me tokën, kemi disa informacione nga autorët antikë, ku kuptohet se toka tek ilirët jepej me qira. Shih Strabonis, *Geographica*, VII, 5, 5; STEPHANI BYZANTINI, *De Urbibus et populis*, 285, 5; TIT-LIVI, *Ab Urbe Condita* XLC, 18.

³⁰ Shih për këtë problem M. CRAWFORD, *Money and exchange in the Roman world*, *Journal of Roman Studies*, 60, 1970, f. 43-45.

³¹ VARRONIS, *De Re Rustica*, I, 17, 2: “Të gjitha tokat punohen nga skllëvër ose njerëz të lirë, ose nga të dyja palët bashkë; nga të lirët ose kur i punojmë vetë siç bëjnë shumë të varfër me familjarët e tyre, ose me njerëz të paguar, atëherë kur më të lirët kryejnë punët më të rëndësishme, siç janë vjeljet dhe korrjet, dhe këta quhen prej tonëve oberari; këta edhe sot gjenden me shumicë, në Azi, Egjipt dhe në Ilirik. Mbi të gjitha këto dua të them se është më mirë që vendet e vështira të punohen me njerëz me pagesë sesa me skllëvër; gjithashtu edhe në vendet më të shëndosha, ata të ngarkohen me punët bujqësore më të rënda siç janë tharja e frutave, vjeljet e korrjet.”

përhapur tek ilirët dhe epirotët që para ardhjes së romakëve. Këtë gjë e pohojnë aktet e lirimit të skllëverve në Butrint³². Po ashtu edhe autorët antikë na flasin për një numër të madh skllëverish që shfrytëzoheshin nga ilirët për të punuar tokën. Theopompi shkruan se ardianët dispononin 300 000 *prospelatë*, kjo kategori përkon me bujq të shpronësuar dhe që detyroheshin të punonin tokën e pronarëve të mëdhenj³³. Ndërsa Agatharkidi shkruan se elita dardane dispononte deri në 1000 skllëvër që përdoreshin jo vetëm për të punuar tokën, por edhe si ushtarë në luftë³⁴. Të gjitha këto informacione, megjithëse mund të pranohen disi me rezerva³⁵, na bëjnë me dije se mbajtja e skllëverve ishte një fenomen i përhapur tek ilirët dhe si rrjedhojë puna e tyre ka qenë thelbësore për zhvillimin e ekonomisë.

Kategoria e njerëzve të lirë përbënte një klasë tjetër të rëndësishme të shoqërisë romake provinciale dhe të ekonomisë rurale. Por kemi të bëjmë me një kategori shumë fluide, çka e bën atë edhe shumë heterogjene në të njëjtën kohë³⁶. Fakti që Varroni përmend Ilirinë si shembull për *obaerarii*, tregon se ata luanin rol të rëndësishëm ekonomik, duke qenë se përmenden për punët më të vështira. Nga teksti i Varronit mund të supozojmë se kemi të bëjmë me një grup shoqëror që ekzistonte edhe para ardhjes së romakëve dhe se ata nuk mund të jetonin vetëm me pronën e tyre të vogël, çka i detyronte të punonin me sezone te pronarë më të mëdhenj.

Nga të dhënat që disponojmë, nuk jemi në gjendje të krijojmë një ide se cila nga të dyja këto grupe luante rolin kryesor në prodhim! Për momentin mund të hipotezojmë se kemi të bëjmë edhe me një ndarje sipas specialitetit, për shembull njerëzit e lirë dhe skllëverit e specializuar luanin një rol më të madh për aktivitetet artizanale, ndërsa skllëverit e tjerë për punë më të rëndomta.

Gjithashtu edhe gratë duket se kishin rol kyç në aktivitetet ekonomike të familjes. Po nga Varroni mësojmë se gratë në Iliri merreshin me ruajtjen e kopeve, përgatisnin ushqim për barinjët apo ruanin materialet. Këto femra ishin të forta dhe nuk u linin gjë mangut burrave në punët që bënin³⁷.

³² P. CABANES, *Les inscriptions du théâtre de Bouthrotos, Actes du colloque 1972 sur l'esclavage, Annales littéraires de l'Université de Besançon*, 163. Paris, 1974, f. 105-210.

³³ ATHENAËI, *Deipnosophistae*, VI, 271e. Veprat e Agatharkidit dhe Theopompit janë tashmë të zhdukura por informacionet e tyre janë rimarrë dhe na janë transmetuar nga Atheneu.

³⁴ ATHENAËI, *Deipnosophistae* VI, 272d: "Agatharkidi, nga Knidi, në librin e tridhjetë e tetë të veprës "Europaikon" thotë se dardanët kanë aq shumë skllëvër, sa dikush kishte njëmijë... kurse të tjerë edhe më shumë. Secili nga këta [skllëvër] në kohë paqeje punon tokën, kurse në kohë lufte merr pjesë në ushtri, duke pasur si prijës të zotin e vet".

³⁵ Sipas Z. MIRDITËS, *Studime Dardane* 1982, f. 69 këto shifra janë të ekzagjeruara, sepse skllavëria nuk ka luajtur rol të rëndësishëm te dardanët dhe se bujqësia ka qenë e dorës së dytë.

³⁶ Shih P. GARNSEY, *Non-slave labour in the Roman World*, P. Garnsey (ed.) *Non-slave labour in the Greco-Roman World*. Cambridge Philological Society, Supplementary volume no. 6, Cambridge, 1980, f. 38.

³⁷ VARRONIS, *De Re Rustica*, II, 10, 5. "...Për ata që banojnë në bjeshkë e në vende pyjore dhe mbrohen nga shirat jo nëpër vila, por në kasollet e para që hasin, shumë vetë e quajnë më të

Përveç mineraleve, Iliria njihej edhe për burimet e bitumit, një element ky shumë i shfrytëzuar në antikitet, sidomos për izolimin e anijeve. Straboni na informon për praninë e burimeve të asfaltit në territorin e Apollonisë⁶⁷. Edhe autorët e tjerë antikë japin informacion për këto burime, te të cilat ishte ndërtuar edhe një orakull⁶⁸. Zjarri i Nymfeut prezantohet edhe në monedhat perandorake të prera në Apolloni⁶⁹. Megjithatë, deri sot nuk kemi asnjë gjurmë arkeologjike të shfrytëzimit të tyre në antikitet.

Duke u bazuar në informacionet e autorëve antikë për minierat e Ilirisë dhe shfrytëzimin e tyre gjatë periudhës romake, O. Davies ka arritur në mendimin se në fund të shekullit II dhe fillim të shekullit III e.s. minierat e Ballkanit zëvendësojnë për nga rëndësia ato të Spanjës që në këtë periudhë po ezauroheshin nga shfrytëzimi i gjatë⁷⁰. Megjithëse të dhënat arkeologjike që kemi nuk janë të shumta, kjo hipotezë edhe mund të qëndrojë. Po të kemi parasysh faktin se përgjatë antikitetit të vonë numri i objekteve metalike që gjenden nëpër varre rritet ndjeshëm, na bën të mendojmë për një industri të madhe të përpunimit të metalit. Gjithashtu, në favor të kësaj ideje është dhe fakti se gjatë antikitetit të vonë shohim të shfaqen në Iliri edhe *procuratores metallorum*, që përmenden në Kodin e Teodosit⁷¹. Këta prokuratorë kishin si qëllim mbikëqyrjen e punës në miniera. Një shembull i rëndësishëm na vjen për vitin 386 kur marrim vesh se disa prej këtyre prokuratorëve kërkuan t'i shmangeshin detyrës nga frika e dyndjeve barbare në rajon, por perandori Gracien i detyroi t'i riktheheshin punës⁷².

Siç tregohet edhe nga vendosja e shumë siteve rurale në zonat pranë burimeve minerare, romakët i shfrytëzonin këto miniera në bazë të punës dhe eksperiencës së banorëve vendës, çka duhet të ketë sjellë dhe një vazhdimësi të jetës në këto zona⁷³. Në rajone të tjera, gjatë periudhës romake, prania e minierave ka çuar në krijimin e shumë municipeve të reja⁷⁴, ndërkohë që për Ilirinë, siç e përmendëm dhe më lart, informacionet janë ende shumë të pakta.

⁶⁷ STRABONIS, *Geographica*, VII, 5, 8: “Në krahinën e apolloniatëve është një vend i quajtur Nymfe, një shkëmb aty nxjerr zjarr dhe nën këtë rrjedhin burime të vakëta dhe asfalt, mbasi, siç shihet qartë, digjen plisat e asfaltit. Aty pranë ka një minierë, mbi një kodër; me kohë gropat e minierës mbushen përsëri dhe dheu që bie në to, shndërrohet në asfalt, sikurse e thotë Poseidoni.”

⁶⁸ PLINI, *Naturalis Historiae*, XVI, 59; Ovidi, *Fastes*, II, 658; Vitruvius, *De Architectura*, VIII, 3, 8; Cassius Dio, *Historia Romana*, XLI, 45, 2.

⁶⁹ Sh. GJONGECAJ, O. PICARD, *Le monnayage d'Apollonia sous l'Empire romain*, P. Cabanes, J.-L. Lamboley (éd.) *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité IV*, actes du IV^e colloque international (Grenoble 10-12 octobre 2002), Paris, 2004, f. 135-148.

⁷⁰ O. DAVIES, *Roman Mines in Europe...*, f. 242.

⁷¹ *Codex Theodosianus* I, 32.5.

⁷² *Codex Theodosianus* I, 32.5.

⁷³ S. SHPUZA, *L'espace rural illyro-épirote...*, f. 613.

⁷⁴ Shih S. DUŠANIĆ, *Aspects of Roman mining in Noricum, Pannonia, Dalmatia and Moesia Superior, Aufstieg und Niedergang der Romischen Welt*, 6, II, 1977, f. 52-94.

Ashtu si minierat, edhe guroret përbënin një element të rëndësishëm të jetës ekonomike në Iliri. Për shembull, rasti i Byllisit është shumë i veçantë, sepse guroreja ndodhet brenda territorit të qytetit. Studimet e deritanishme në të kanë treguar se kjo gurore është përdorur intensivisht gjatë periudhës perandorake romake⁷⁵. Ndërkohë guroreja e Karaburunit është nga më të përdorurat në antikitet, sidomos nga qytetet e Orikut dhe Apollonisë, që e kishin këtë gurore burimin kryesor të materialit ndërtues (fig. 5). Një tjetër gurore ndodhet në fshatin Shkallë, pranë Butrintit⁷⁶. Kjo duket se ka shërbyer më shumë për ndërtimet e Butrintit dhe Çukës së Ajtoit. Gjurmët e nxjerrjes së gurëve janë ende të dukshme në këto gurore.

Përveç mineraleve, këto zona ishin shumë të pasura edhe me pyje, që përbënin gjithashtu një degë të rëndësishme të ekonomisë për romakët. Por është e pamundur të gjejmë gjurmë arkeologjike të shfrytëzimit të pyjeve në antikitet. Edhe në këtë rast janë tekste të autorëve antikë që na japin pak informacion. Për shembull mund të përmendim rastin e *Statilius Taurus* që përdori pyjet e zotërimeve të tij rrotull Dyrrahut, për të ndërtuar një amfiteatër prej druri në Romë⁷⁷.




Fig. 5. Pamje nga guroret e Karaburunit dhe Byllisit.

⁷⁵ P. CHEVALIER *et al.* *Byllis*, Travaux de l'École française d'Athènes en 2003-2004, *BCH*, 128-129, 2004-2005, f. 1218-1223.

⁷⁶ K. ZHEKU, *Zbulimi i një guroreje antike në Shkallë të Konispolit*, *BUSHT*, 1963, 1, f. 228-231.

⁷⁷ C. R. WHITTAKER, *Trade and aristocracy in the Roman Empire*, *Opus*, 1985, IV, f. 59.

Përfundime

Toka dhe bagëtitë ishin baza e pasurisë në antikitet. Për këtë edhe pushtimi romak pati si synim marrjen në zotërim nga elita romake të pronave të mëdha. Shkatërrimet e Pal Emilit në Epir, luftërat civile në Iliri apo korrupsioni i guvernatorëve romakë të periudhës republikane na krijojnë idenë se në shekullin I p.e.s. gjendemi përballë një territori të shkatërruar. Për më tepër fenomeni i braktisjes së qendrave ilire në këtë periudhë çoi edhe në braktisjen e kulturave bujqësore, duke krijuar një lloj shkëputjeje. Po t'u shtojmë këtyre fenomeneve edhe kolonizimin romak që çoi në një rindarje të pasurisë dhe të pronave, arrijmë në mendimin se shekulli I p.e.s. përbën një moment kyç në transformimin e ekonomisë ilire. Format e vjetra të prodhimit u zëvendësuan nga ato të romakëve, të cilët riorganizuan hapësirën rurale, modifikuan thellësisht pronësinë dhe mënyrat e punimit të tokës. Sidomos dalja në skenë e vilave bëri që rreth tyre të organizohej e gjithë jeta ekonomike. Ato bënë që të rritej prodhimi bujqësor dhe format e prodhimit të modernizoheshin. Por, siç tregojnë edhe autorët antikë, ekonomia familjare luante një rol të rëndësishëm, paralelisht me atë të pronave të mëdha bujqësore.

Megjithatë, përveç këtyre ndryshimeve radikale që ndodhën me pronësinë e tokës dhe me riorganizimin e prodhimit bujqësor, vihet re edhe një farë vazhdimësie në disa site me karakter agrar, siç është rasti i fermave helenistike të fortifikuara që shndërrohen në vila. Po ashtu edhe në zonat malore, interesi i Romës për të pasur në miniera një forcë punëtore të specializuar, bëri që edhe atje të kemi vazhdimësi të formave të organizimit pararomak. Këta shembuj tregojnë se ato zona që nxirrnin përfitime ekonomike të rëndësishme, vazhduan të shfrytëzoheshin edhe me ardhjen e romakëve.

Në përgjithësi ekonomia antike ilire ishte një ekonomi autokonsumi, por informacionet e autorëve të asaj kohe hedhin dritë mbi faktin se mbretëritë, koinonet apo qytetet luanin një rol drejtimor në ekonomi që ndoshta kishte të bënte me shpërndarjen e pasurisë natyrore dhe me organizimin e saj. Qoftë mbretëritë, koinonet, fiset apo qytetet kishin një territor të tyrin në zotërim, çka përbënte dhe territorin e tyre ekonomik. Si rrjedhojë e këtij fakti mendojmë se kemi të bëjmë me një ekonomi shumë të fragmentuar lokalisht dhe që shtrihej deri në kufijtë e pushtetit politik të mbretit, koinonit apo qytetit.

Me ardhjen e romakëve vërejmë se elementët ekonomikë që shfrytëzohen, janë po të njëjtë me ato të periudhave të mëparshme, por në tre shekujt e parë të e.s. vihet re një intensifikim më i madh i prodhimit.

ASPECTS OF ANCIENT ILLYRIAN AND EPIROTIC ECONOMY

Introduction

Ancient authors and archaeological excavations gives important data on the ancient economy. However, this remains one of the subjects not studied until now. Our aim in this article is not only to write the story of the ancient illyrian and epirotic economy but also an essay to know and analyse thematically its structures. In this context, when the data we dispose are rare, the study is going to be more descriptive in order to be closed to the reality.

First of all, the notion of economy is related to the terms of work, production, capital, investment, circulation etc. However, in this article we will be focusing only in some aspects of ancient illyrian and epirotic economy such as agriculture, farming and mining.

Agriculture and *villae*.

Agriculture was the major economic activity during the antiquity. For the fertility of the illyrian territory there a few data from the ancient authors such as Herodotus, Scymnos and Strabo. The developpement of agriculture during the hellenistic period seems to have been very important. This is visivle in the growing number of farms around the main cities and from the discovery of many agricultural tools in many sites. This agricultural developpement during the IIIrd-IInd centuries B.C. had as a consequence the augmentation of the production, even on an exporting level. For example, the italian businessmen installed in Epirus and Illyria didn't came just to sell they productions, such as oil and wine, but also to be furnished with corn.

For a developed agricultural economy testify also the historical data for the pillage of the corn of the Parthins and Epirots by the Romans. Moreover, during the second war of Macedonia in 199 B.C. the roman consul Sulspicius passed through Dasaretia and feeded his army only with the productions of the region. While in the Korça bassin and in Qesarat there are many *pythoi* discovered which served for the storing of the production. The feeding of the army during the wars was one of the major problems. As Cesar states himself his aim was to march as quicly as possible and to be furnished by locals. As we perceive indirectly from these informations, wars have been devastating for these regions but on the other hand they show that illyrian production was developed in such a scale to feed the Roman armies.

Although that for the hellenistic period ancient sources and archaeological data document an important agricultural developpement, during the Roman period we see

the appearance of new structures related to the economy and production. These structures are represented by the *villae* which are at the same time the most important Roman constructions in the rural territory. The *villae* known until now are more represented in the territory of Epirus than in Illyria but they have also their particularities.

Diaporit is one of most known *villae* in Epirus. The construction of this monument has known many phases. The beginnings belong to the hellenistic and republican period while the second phase to the imperial period. While in the IIIrd century the villa is abandoned and other activities took its place. On the other side Dobra, Çuka, Metoqi and Malathrea represents the typical plan of the epirotic *villae*. These are small fortified farms, hellenistic in origin and transformed into *villae* during the Roman period. The fact that they become bigger during the Roman era shows that there is a growing agricultural activity with the Romans. Probably to this fact helped also the amelioration of agricultural techniques and new methods for the land working. None of the *villae* is furnished with mosaics, sculptures which means that they were not luxury buildings. Their plan is very simple and compact, all the rooms are organised around a central courtyard, similar with a perystyle. During the Roman period the towers which served to protect the production during the hellenistic period came out of function.

For the territory of South Illyria the *villae* are mostly present around the territories of the Roman colonies such as around Shkodra and *Dyrrachium*. Their presence is a sign of the distribution in Illyria of the Roman ways of living and of agricultural organisation. All the *villae* are situated around the main cities, near the main roads of communication and the more fertile lands.

However, the *villae* were not the only way of economic organisation. On most part of the territory we see a great concentration of rural sites which represent to us a very fragmented territory. This idea of a fragmented territory is also supported by the fact that rural necropoles of the Roman period are composed by very few tombs. In this context, we think that the base for the economic organisation was the small family which owned a small land and that their production was only for autoconsumation. We are dealing here with an agrarian society which probably conserved old methods of work in agriculture and which was concentrated on isolated areas far from the main roads of communications and cities.

For these, we think that Illyrian economy was “primitive”, the quantity of production was small, the production technology knew very few developpements and was very dependant on wether variations. This is also related to the problem of the monetarisation of the illyrian economy. The numismatic finds in rural territory are absent which probably means that overproduction was a very rare phenomenon. Beside the fact that coins were issued since the IVth century B.C. they didn't played an important role in the rural economy.

Being one of the most important branch of ancient economy, agriculture, demanded the engagement of many workers. These workers were mostly free peasants or slaves.

Slavery was known to the Illyrians and Epirots before the coming of Rome. Ancient authors and inscriptions testify this fact. But also freemen, known from the sources as *obaerarii* were important in agriculture. We are dealing here with a fluid social group which was present before the Romans came.

Unfortunately, from the data we dispose we are not able to tell which of these groups was more important from the agriculture. For the moment we can hypothesise that there was a certain specialisation of work, for example freemen were more engaged with artisanal work while other slaves for more heavy work.

Women also seems to have played a big role on the agriculture and family economy. After Varro women in Illyria were able to garde animals, to prepare food for the shepards and their work is similar to that of men.

Farming

Farming was the main economic activity in Epirus. This is also testified by ancient authors. This branch of economy had as a consequence also the production of milk, meat and wool. Unfortunately the archaeological excavations hasn't yet discovered such sites. But we can also presume that wool produced in Epirus was exported in Italy, viewing the fact that this economic activity was in the hands of Italic businessmen.

Horses also were bred from the Epirots. A text of Virgile suggest also that these horses were probably also exported to Rome. Probably the Italians developed further the long tradition of horse-breeding in Epirus.

Minning

Mines are the less known aspect of Illyrian economy. In this context, ancient sources are the starting point for us to their study. In Albanian territory we know only sporadically some adit's near *Lissus*, Puka and Kukës. Meanwhile, archaeological data on minning sites are completely lacking. On the other hand ancient sources are abundant. Even that these authors are Romans they indirectly testify that minning was an important economic activity even before their arrival. Some of the Illyrian tribes were so known for their experience in minning that they were deplaced to work in the minning of Dacia by Trajan. Apart minning, also work on quarry's and on the bitum sources are known in Illyria.

Conclusions

The destructions of war gives the impression that Illyria and Epirus were a devastated territory in the 1st century B.C. Moreover the colonisation process made by the Romans contributed to the redistribution of the land but also to the appearance of new forms of economic organisation, such as the *villae*.

Apart the new introductions made by the Romans we see also the continuity of

previous activities in rural sites and in minning sites. Also old forms of economic organisation coexisted with the new ones. In general, we are dealing with an autoconsuming economy and very fragmented at the local level.

Land and animals were the basis of richness in antiquity. With the coming of Rome these economic elements being exploited are the same as in the hellenistic period but during the three first centuries A.D. there's a greater intensification.